



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:174993

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05860525

Ac.nr. 3808/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Nora Bllaca Dula e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi Saraçi, në çështjen kontestimore të paditëses “E...”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit J. N nga Komuna e Gjilanit, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 722/2019 të datës 29.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si e bazuar, ankesa e paditësit Kompania e Sigurimeve “E...”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 722/2019 i datës 29.12.2020, PRISHET dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

A r s y e t i m

Rrethanat e çështjes:

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, hedhet poshtë padia e paditëses “E...” Prishtinë, e ushtruar në këtë gjykatë me datën 14.08.2019 kundër të paditurit J. N, nga Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti rimbursim i dëmit me vlerë të kontestit 370 €.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar paditësja, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e palës paditëse ta aprovoj dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 208 e 209 të LPK, gjeti se:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Kompania e Sigurimeve “E...”, ka parashtruar padi ndaj të paditurit J. N, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit, në vlerë prej 370.00€.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të atakuar me ankesë ka theksuar se e njëjta nuk ka mundur të komunikoj me të paditurin në adresën e dhënë si në padi, nga se në dërgesën personale të Postës së Kosovës është kthyer konstatimi i datë 22.10.2020, se “pala i panjohur verifikon mbiemrin, nuk e njih askush në fshat”. Gjykata e shkallës së parë përmes aktvendimit C.nr.722/2019 të datës 26.10.2020, paditëses i’a ka kthyer në plotësim padinë sa i përket adresës së të paditurit apo në të kundërtën të deponoj shumën prej 257.4 € në emër të paradhënies për shpërblimin e punës së përfaqësuesit të përkohshëm. Paditësja me parashtrësën e datës 10.11.2020 e në raport me aktvendimin e lartcekur e ka theksuar se “adresa e saktë e të paditurit është në ... Komuna e Hanit të Elezit”. Gjykata ka provuar përsëri të komunikoj me të paditurin në adresën e lartcekur por nga dërgesa personale e Postës së Kosovës është kthyer konstatimi se “tentimi është bërë me datën 25.11.2020, marrësi është pa adresë në Hani i Elezit, nuk ekziston askush me këtë emër dhe mbiemër”. Gjykata përsëri përmes aktvendimit C.nr.722/2019 të datës 08.12.2020, i’a ka kthyer paditëses në plotësim duke e detyruar paditësen që në afat prej tre ditësh të bëjë deponimin në arkën e kësaj gjykate shumën prej 257.4 € në emër të paradhënies për shpërblimin e punës së përfaqësuesit të përkohshëm, nën kërcënimin se padia e paditëses do të hedhet poshtë nëse paditësja nuk e deponon shumën e lartcekur.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktvendimin gjykatës së shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi, pika n) lidhur me nenin 184 të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK- së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: c) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, nuk e miraton Gjykata e Apelit e Kosovës. Kjo pasi që kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe është bërë edhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale. Shkeljet e dispozitave kontestimore konsistojnë në shkelje nga neni 182.1, lidhur me nenin 99.2 dhe 102 të LPK-së. Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, çështjet që kanë të bëjnë lidhur me adresën nuk paraqesin çështje që lidhem me mos plotësimin e padisë nga neni 99 dhe 102 i LPK-së. Gjykata në bashkëpunim me palët në procedurë duhet që të shterojnë të gjitha mundësitë ligjore për mbarëvajtjen e shqyrtimit gjyqësor. Kolegji nuk ka miratuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë kur ka kërkuar nga pala paditëse që të bëjë deponimin e shumës për përfaqësuesin e përkohshëm në ndërkohë që para kësaj nuk ka marrë vendim për caktimin e të njëjtit. Gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur që pas konstatimit të mos ekzistimit të palës në adresën e dhënë nga ana e palës paditëse, të shohë mundësitë e gjetjes së adresës përmes evidencës së regjistrimit civil duke e obliguar palën paditëse që të bëjë një gjetje të tillë dhe krejt në fund në qoftë se edhe kjo përpjekje ka rezultuar e pa suksesshme, të futet në përdorim çështja e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm. Nga kjo, kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk i ka shterur të gjitha mjetet ligjore në rastin e vendosjes në këtë çështje kontestimore. Për këto arsye kolegji i Gjykatës së Apelit, ka konsideruar se qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse, dhe ka vendosur që aktvendimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në ri procedim në gjykatën e shkallës së parë.

Në procedurë të serishme gjykata e shkallës së parë, duhet që të vazhdoj me procedimin e çështjes konform udhëzimeve të dhëna më lartë dhe pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike e me aplikimin e drejtë të të drejtës materiale, të nxjerr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje kontestimore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1, pika d) dhe 195 par.1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3808/2021 me datë 24.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj